



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 9

Prishtinë, më 9.2.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj, Besa Gaxherri, Liburn Aliu, Lutfi Zharku, Andin Hoti, Enver Hoti, Salih Salihu, Danush Ademi, Ganimete Musliu dhe Driton Çausi.

Mungoi : Sërgjan Mitroviq.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Daut Haradinaj**, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Gjendja në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz dhe nisma legjislative për ligjin;

Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit: E hapi mbledhjen e caktuar sot për shkak të gjendjes alarmante në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz, rreth dëmtimeve të kullave, e cila pikë është e caktuar për të hënë, por pasi që është dërguar edhe peticioni nga Jusuf Thaçi, është pa si e arsyeshme që të reagojë komisioni në mënyrë ashtu siç kërkohet. Njëherësh kërkoi nga stafi të shpërndajë listën për nënshkrime rreth nismës legjislative për hartimin e Ligjit për këtë kompleks, ligj ky i cili ka filluar të hartohet në legjislacionin e kaluar dhe ka shkuar deri në leximin e dytë, por për shkak të përfundimit të Legjislaturës V, tani duhet sërish të procedohet, prandaj për fillim, ftoj drejtorin e Agjencisë për Komplekse Memoriale z. **Idriz Blakaj**, t’ia sqarojë komisionit çka është duke ndodhur në këtë kompleks, i cili sqaroi se i njëjti në këtë agjenci është në fund të mandatit, por me problemet të cilat i ka gjetur aty dhe me lëvizje shumë të ngadalshme pozitive.

Sikurse deputetët tjerë, ashtu edhe z. Idriz Blakaj falënderoi z. Jusuf Thaçin prej shoqërisë civile për angazhimin me peticion dhe sensibilizimin e opinionit për këtë çështje. Ai në vazhdim foli për projekte të cilat edhe më tej e kanë rëndur gjendjen alarmante dhe nuk janë miratuar dhe përfunduar dhe tash kërkimi i përgjegjesisë sipas tij është tek të gjithë krerët institucionalë, ngase çka mund të ndikojë kjo agjenci me tre punëtorë në këtë kompleks kurse me ligj i është lejuar 52 do të thotë gjithsej 9 punëtorë, vetëm 3 në këtë kompleks.

Pasi që kryetari **Daut Haradinaj** polemizoj me drejtorin Idriz Blakaj rreth përgjegjesisë, anëtarët tjerë të komisionit, **Ganimete Musliu**, apeloj që të gjitha gjërat të lihen anash në favor

të mbrojtjes së kullave nga shkatërimi, për të cilin fakt paraqiti edhe shënimet nga viti 2014 , e gjithmonë është angazhuar për ruajtjen dhe konservimin e kullave të Jasharajve, çka edhe **Salih Salihu** pikërisht për këtë u angazhua, kurse **Andin Hoti** reagoi ngjashëm sepse siç tha ai, 18 vite pas luftës nuk mjaftuan por vetëm fjalë, turp.

Liburn Aliu, kërkoi kristalizimin e çështjes së fajtorit ngase ligjet janë dhe nuk mund të jenë të gjithë bashkërisht fajtorë, të hollat kanë shkuar në kulturë, pse kanë shkuar aty dhe pse nuk janë kthyer ku duhet dhe shumë pyetje tjera që kërkojnë sqarim.

Enver Hoti, tha se përgjegjësia i takon drejtorit aktual të agjencisë, i cili ka mundur thjesht të jep dorëheqje dhe të sqarohen gjërat, kurse për gjendjen aktuale kërkoi intervenimin urgjent të Qeverisë, ndërkaq komision të vazhdojë me hartimin e ligjit, i cili ka filluar në Legjislaturën V, por nuk ka përfunduar, kurse tani do të përfundojë, ashtu si duhet dhe me disa përmirësime shtesë.

Daut Haradinaj, nuk deshi të mbrojë drejtorin, por arsyetoi mosveprimin e tij për shkak të buxhetit shumë të vogël dhe transferimin e vonuar të projekteve nga MMPH-ja tek Agjencia dhe gjithashtu potencoi se komisioni nuk kërkon fajtorin, por të ndikojë në përmirësimin e situatës.

Besa Gaxherri, theksoi se pos komisioneve ekzistuese, duhet të formohet edhe një financiar për të mbikëqyrur se si janë zbatuar projektet nga viti 2010 e deri më tani në këtë agjenci, pas së cilës prapë pasuan disa polemika për fajësi në mes drejtorit dhe disa anëtarëve tjerë.

Daut Haradinaj ftoi **Jusuf Thaçin**, për të thënë atë çka dëshiron, por tha se nuk është vetëm ai meritator për sensibilizim, por mediat, kurse për çështjet konkrete të diskutuara në këtë takim, ju ofroi shikimin me llap-top komisionit, konkretisht se çfarë projekti ofron projekti Italian, të cilin ai e quajti më tepër si “kopsht i të dashuruarve” se sa ndonjë vend heroik, njëherësh kërkoi masa emergjente : **roje 24 orë, kamera 24 orë, zëvendësimi i trarëve të kalbur dhe sanim të plasaritjeve.**

Daut Haradinaj, në fund konstatoi se Komisioni nxori këtë :

P Ë R F U N D I M

Miratohet nisma legislative për hartimin e Ligjit për Kompleksin “Adem Jashari” në Prekaz.

Javën që vjen, Komisioni do të vizitojë kompleksin në Prekaz, kurse për datën e vizitës, Komisioni do të njoftohet në fillim të javës.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetar i komisionit,

Daut Haradinaj